



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
 OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.256/2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE-Departamenti për Krime te Renda ne Pejë, Kryetari i Trupit Gjykues -gjyqtari Sylë Lokaj, dhe gjyqtaret Sami Sharaxhiu e Sejdi Blakaj anëtarë te trupit gjykues, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Binake Mulliqi, sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime te Renda ne Pejë, PP.nr.352/2015 dt.26.10.2015, kundër te akuzuarit XH.D., për shkak të veprës penale vrasje e mbetur në tentativë nga neni 146 lidhur me ne nenin 20 të KPK-së, dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve neni 328 par.2 të KPK-së, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesorë verbalë-publik, ne prezencën e prokurorit te Shtetit, Haxhi Sinanaj, të dëmtuari Z.G, te akuzuarit dhe mbrojtësit Av.M. H., më dt.**14.03.2017**, mur dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **XH.D.**, i biri i A. dhe nënës Sh. e gjinisë H, i lindur me ... në Fsh.J K-Klinë, tani me banim në Rr. ““ , i gjendjes se ekonomike ,....., shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës, ka qenë në paraburgim nga dt. 30.09.2012 gjer më 31.12.2012,tani gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

- Për shkak se :

1.Me dt.30.09.2012, rrethe orës 6, 30 ne Rr. “ Abedin Rexha “ ne Klinë, duke vepruar ne tejkalim te mbrojtës se nevojshme ka tentuar ta privoj nga jeta tani te dëmtuarin Z.G. nga Klina, ne atë mënyrë qe ditën kritike gjer sa i dëmtuari Z. , ishte takuar me te pandehurin XH., e për shkak te një konflikti familjar qe ata e kishin pasur ne mes vetë , i dëmtuari Z. e sulmon me një shufër metalike te pandehurin , e ne atë moment i pandehuri e nxjerre pistoletën e tipit “ Ekcol-Special- modeli 99, kal.7.65 mm, dhe me te njëjtën shtën njëherë ne drejtim te viktimës , me një predh e godet ne pjesën e abdomenit , duke i shkaktua lëndime serioze trupore , pastaj viktima dërgohet ne trajtim mjekësorë ne Spitalin Rajonal te Pejës , ndërsa i pandehuri është arrestua nga Policia.

-me çka ka krye vepër penale te vrasjes ne tentativë e duke vepruar ne tejkalim te mbrojtjes se nevojshme nga neni 146 lidhur me nenin 8 par.3 dhe nenin 20 te KPK-së.

2. Me parë ka siguruar e gjer me dt.30.09.2012, pa autorizim ka mbajtur armë dhe municion dhë atë nje pistolete të tipit “ Ecol-Special model 99” cal 7.65mm me numër serik EV-1236591 e me të cilën armë ditën kritike me datë,kohë dhe vende të përshkruar si ne dispozitivin nen I, ka tentuar ta privon nga jeta te dëmtuarin Z.G. nga Klina.

-me çka ka kryer vepër penale, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve neni 328 par.2 të KPK-së

Për këtë gjykata ne kuptim te nenit 71 par. 1 të KPK-së të akuzuarit i:

P e r c a k t o n

Për veprën penale në pikën 1 të dispozitivit të aktgjykimit, dënim burgimi në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj.

Për veprën penale në pikën 2 të dispozitivit të aktgjykimit, dënim burgimi në kohëzgjatje prej tre (3) muaj dhe denim gjobe në të holla në shumë prej dyqindë (200) euro.

Andaj Gjykata në kuptim të nenit 2, 3 par.2, nenit 45, 46, 48, 69, 73, 74, 75, 76 par.1 pika 1.4 , nenit 80 par. 1 e 2 pika 2.5, 83 e lidhur me nenin 178 lidhur me nenin 12 par.3 dhe 4 nenit 28 dhe nenit 375 par.2 të KPK-së (Kodi më i favorshëm ne kohen e gjykimit) e lidhur me nenin 365, 366, 450, te KPPK-së, te akuzuarin e :

G J Y K O N

Me dënim unik burgimi ne kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditë

Në dënim me burg i llogaritet paraburgimi nga dt.30.09.2012 gjerë më 31.12.2012 (90) ditë

Dënim gjobe në të holla në shumë prej dyqindë (200) euro.

Dënim plotësues, konfiskim i armës, një pistolete i tipit “ Ecol-Special model 99” cal 7.65mm me numër serik EV-1236591, e cila pas plotfuqishmërisë e këtij aktgjykimi ka për tu asgjësuar .

Dënimi me gjobe duhet te ekzekutohet ne afat prej 30 ditësh , e nëse i akuzuari e refuzon ekzekutimin , i njëjti dënim zëvendësohet me burg , duke llogaritur për çdo ditë burgu nga 20 euro.

Pjesa e pa ekzekutuar dënimit me burg në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë, me pëlqimin e te akuzuarit, zëvendësohet me pune në dobi te përgjithshëm. Ashtu qe urdhërohet i akuzuari që te kryen punë ne dobi te përgjithshme pa pagës ne kohëzgjatje prej 90 ditësh,

Shërbimi Sprovues i Kosovës, njësia në Pejë, do te vendos për llojin e punës ne dobi te përgjithshme qe duhet ta kryej i akuzuari, cakton organizatën e veçantë qe do te kryej punët ne dobi te përgjithshme , vendose për ditët e javës gjatë te cilave, punën ne dobi te përgjithshme duhet te kryhet dhe mbikëqyrë të akuzuarin gjatë ekzekutimit të punës ne dobi te përgjithshme .

Puna ne dobi te përgjithshme duhet te filloi ditën kurë e cakton Shërbimi Sprovues i Kosovës-njësia në Pejë, e nëse i akuzuari nuk e kryen punën ne dobi te përgjithshme apo e kryen vetëm pjesërisht , gjykata urdhëron dënim me burg . Një ditë burgimi do te urdhërohet për çdo 8 orë pune ne dobi te përgjithshme qe nuk është krye.

I akuzuari detyrohet qe gjykatës ne emër te paushallit gjyqësorë te i ja paguaj shumen prej 25 euro .

I dëmtuari Z.G. nga Klina, për realizimin e kërkesës eventuale për dëmshpërblim udhëzohet ne kontest civil.

Te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh , pasi qe aktgjykimi te merre formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokurori i Shtetit pranë Prokurorisë Themelore –Departamenti për Krime te Renda ne Pejë, me aktakuzën PP.nr.354/2012, te dt.26.10.2015, e ka akuzuar te akuzuarin XH. D., me çka ka krye vepër penale te vrasjes ne tentativë e duke vepruar ne tejkalim te mbrojtjes se nevojshme nga neni 146 lidhur me nenin 8 par.3 dhe nenit 20 te KPK-së, dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve neni 328 par.2 të KPK-së Ne shqyrtim kryesor Prokurorja e Shtetit Haxhi Sinanaj, ka mbete ne tersi pranë aktakuzës, kualifikimit te njëjtë juridik te veprës penale.

I akuzuari XH.D., qe ne fillim te shqyrtimit gjyqësorë , ne tersi e ka pranua fajësinë për veprat penale për te cilën akuzohet.

Prokurori i Shtetit është pajtua me pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Me qenë se i akuzuari që në fillim të shqyrtimit gjyqësorë , në tersi e ka pranua fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet , prokurori i Shtetit është pajtua me pranimin e fajësisë, gjykata është binde se i akuzuari e ka kuptua natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë , pranimi i fajësisë është i vullnetshëm dhe është bere pas këshillave te mjaftueshëm nga mbrojtja, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet e çështjes qe përmban akuza dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe te pranuar nga i akuzuari , aktakuza nuk përmban as një nga shkeljet e qarta ligjore. Me këtë janë përmbush të gjitha kushtet e parapara me nenin 248 par.1 të KPPK-së. Për këtë gjykata ne kuptim te nenit 326 par 4 të KPPK-së e ka pranua pranimin fajësisë nga ana e te akuzuarit për veprës penale vrasje e mbetur në tentativë nga neni 146 lidhur me ne nenin 20 të KPK-së, dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve neni 328 par.2 të KPK-së.

Prokurori i shtetit Haxhi Sinanaj në fjalën përfundimtare ka deklarua : Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, nuk ka dyshim se ai i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpalli fajtor, ta gjykoj në bazë të ligjit ta detyroj në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, si dhe ti shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i armës e cila ka qenë objekt i veprës penale, ndërsa sa i përket vendosjes për dënim i propozoj gjykatës ti merr rrethanat lehtësuese pranimin e fajësisë, faktin se ai e ka arritur pajtimi me palën e dëmtuar.

Mbrojtësi i te akuzuarit Av. M. H. ne fjalën përfundimtarë deklaroi: Me qenë se i mbrojturi im pas këshillave të mjaftueshme e ka pranuar fajësinë për veprën penale tani të cilësuar, e që ky pranimi i fajësisë është i bazuar në provat e akuzës, nuk ka dyshim se ai i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, mbrojtjes i mbetet se gjykatës të ja përkujtoj rrethanat rënduese dhe ato lehtësues, lidhur për dënimin me qene se prokurori i shtetit në asnjë fazë nuk ka potencuar me një rrethane rëndues për të akuzuarin, mbrojtja konsideron se qëndrojnë disa rrethana tjera lehtësues dhe atë koha kur është kryer kjo veprë penale që është relativisht e gjatë, fakti se që nga atëherë e deri me tani i akuzuari nuk ka kryer ndonjë veprë tjetër penale, shprehja e pendimit të thellë dhe veprimet e kryera, gjendje tejet e varfër ekonomike fakti se është mbajtës i familjes, pastaj pranimi i fajësisë konsideroj se janë rrethana në tersi posaçërisht lehtësues, gjithashtu gjykatës ja përkujtoj të ketë parasysh lidhjen kauzale në mes të shkakut dhe të pasojës, pastaj fajin se sipas rikualifikimit të dispozitivit të nenit 8 paragrafi 3 të KPP--se, parasheh mundshme që i akuzuari përkatësisht e në rastin konkretë aji mund të lirohet nga dënimi, andaj i propozoj gjykatës se të mbrojturit tim për të gjitha këto rrethana ta liroj nga dënimi apo pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese të ja përkujtoj vuajtën e dënimit në kuptim të nenit 66 e lidhur me nenin 67 të KPPK-se, dhe të mbrojturit tim ti shqiptoj një dënim sa me të bute gjithashtu bazuar në gjendjen ekonomike të të akuzuarit kërkoj nga gjykata që të liron nga detyrimi për shpenzimet e procedurës penale.

I akuzuari XH.D.ne fjalën përfundimtare tha: Në tersi i bashkëngjitem fjalës të dhenë nga mbrojtja nuk kam çka të shtoj tjetër,

Me qen se i akuzuari e ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit kryesorë, gjykata bazuar në provat në shkresat e lëndës raporti i policor nr.2006-DE-269 i dt:17.03.2006, raporti mbi konfiskimin, deklarata e të dëmtuarit dhen në procedurën paraprake, e ka pranua fajësinë e të akuzuarit dhe ka vërtetua se i akuzuari ditën, kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit ka kryer veprë penale vrasje e mbetur në tentativë nga neni 146 lidhur me në nenin 20 të KPK-së, dhe veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve neni 328 par.2 të KPK-së, dhe për këtë e gjet fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të cilat kishin për të ndikua në llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese të i akuzuari gjykata nuk ka gjetë. Ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale –faktin se ai më parë nuk ka qenë i gjykuar për ndonjë veprë penale, sjellja e tij tejet korrekte gjatë shqyrtimit kryesorë, fakti se është mbajtës i familjes, faktin se i akuzuari që në fillim të shqyrtimit gjyqësorë në tersi e ka pranua fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzua dhe është i penduar për veprimet e kryera, e posaçërisht faktin se me palën e dëmtuar është pajtue.

Duke i pasur parasysh edhe këto rrethana gjykata duke aplikua dispozitat për zbutjen e dënimit brenda kufive të lejuar ligjor, të akuzuarit pasi që i ka plërcaktua dënimet për secilën veprë penale, e ka gjykuar me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 180 ditë në të cilin dënim i është llogaritur paraburgimi dhe dënim gjobe në të holla në shumë prej 200 euro si dhe dënim plotësues konfiskimi i armës.

Për pjesë e pa ekzekutuar të dënimit me burg në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë, me pëlqimin e te akuzuarit, është zëvendësua me punë në dobi te përgjithshëm e të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kështu është vendose me bindje te thellë se edhe një dënim i tillë i përgjigjët shkallës se rrezikshmërisë shoqërore te veprës penale te kryer, dhe se i njëjti dënim do te ndikoj dukshëm ne sjelljet e te akuzuarit ne te ardhmen , me çka do te arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i parapare me nenin 34 te KPK-së.

Vendimi për dënimin plotësues është i bazuar me nenin 54 par.1 dhe 2 pika 7 e lidhur me nenin 60 te KPK-së, e me qellim te sigurisë se përgjithshme.

Vendimi qe i dëmtuari për realizimin e kërkesës eventuale për dëmshpërblim, te udhëzohet ne kontest civil, është i bazuar me nenin 463 par.1 dhe 2 te KPPK-se, nga se te dhënat e mbledhura ne këtë procedure nuk paraqesin bazë te sigurt për gjykim të plotë e as te pjesshëm te demit te shkaktuar.

Vendimi qe i akuzuari te ja kompensoj gjykatës shpenzimet ne formë paushalli është i bazuar ne nenin 450 par.2 pika 6 te KPRK-së, dhe është gjykua vetëm për shpenzimet ne formë paushalli , me bindje se i akuzuari i ka kushtet për përmbarrim.

Nga sa u tha me lart është vendose si ne dispozitiv te aktgjykimit.

U VENDOSE NE GJYKATEN THEMELORE – Departamenti për Krime te Renda ne Pejë, me dt. 14.03.2017.

P.nr.256/2015

Procesmbajtësja
Binake Mulliqi

Kryetari i Trupit Gjykes-Gjyqtari
Sylë Lokaj

UDHZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh , pas marrjes Gjykatëse se Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj Gjykate